



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-052

Prishtinë, më 27 shkurt 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 27 SHKURT 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Millosavleviq dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Bilall Sherifi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe
Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 shkurt 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës, më 1 mars 2012,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 shkurt 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 shkurt 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës, më 1 mars 2012

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit, të mbahet të enjten, më 1 mars 2012, me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme,
4. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare,
6. Rekomandimi i Komisionit për Punë të Brendshme , Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së lidhur me vërejtjet e Presidentes në Ligjin nr. 04-L-76 për policinë.
7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme,
8. Shqyrtimi i Propozim- Statutit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës,
9. Njoftimi me Përfundimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, lidhur me Mocionin procedural të GP të Lëvizjes Vetëvendosje,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë.

Visar Ymeri, kryetar i GP të Lëvizës Vetëvendosje, gojarisht kërkoi nga Kryesia, për ta radhitur në këtë seancë- debatin lidhur me çështjen e fusnotës në bisedimet e fundit Kosovë-Serbi.

Kryesia udhëzoi propozuesin që t'i respektojë procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e Avokatit të Popullit për caktimin e pagave për zëvendësit e Avokatit të Popullit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision funksional, që ta shqyrtojë kërkesën e Avokatit të Popullit për caktimin e pagave për zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe lidhur me këtë çështje t'ia paraqesë Kryesisë së Kuvendit, Raportin me rekomandime.

2. Njoftimi për lejimin e udhëtimit të deputetes Flora Brovina, në Britani të Madhe

Kryesia, u njoftua lidhur me lejimin e udhëtimit të deputetes së Kuvendit, Flora Brovina për të marrë pjesë në Konferencën e Gruas Shqiptare Mbarëkombëtare, në Londër, prej 2-5 mars 2012, për të ligjëruar në temën: “ Të arriturat dhe sfidat e shtetit të ri të Kosovës”.

Të gjitha shpenzimet e udhëtimit për deputeten e lartcekur, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:40** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale